

Prishtinë, 22/11/2006  
Kodi i ZRrE-s: D\_24\_2006

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/8 “Mbi Energjinë”;
2. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/9 “Mbi Rregullatorin e Energjisë”;
3. Dispozitat e Udhëzimit të Përkohshëm I\_03\_2006 “Mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrohjes 2006/2007”; dhe
4. Faktin që Ndërmarrja Komunale Publike (NKP) Standard / Njësija e Ngrohjes Qendrore (NjNQ) Termomit nuk ka dorëzuar aplikacionin për tarifën e ngrohjes për sezonin 2006/2007, në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRrE).

Ka vendosur që:

1. Të aprovojë tarifën e ngrohjes për NKP Standard / NjNQ Termomit për tërë gjashtëmuajorin e sezonit të ngrohjes 2006/2007 siç është paraqitur në tabelën “A” dhe “B”; është vendosur që tarifën të mbesin të njëjta si në sezonin e ngrohjes 2005/2006 për shkak të mos-dorëzimit të aplikacionit të tarifave dhe për pasojë mungesën e informatave relevante që duhej të përmbante aplikacioni.
2. Tarifën e aprovuar do të publikohen nga ana e NKP Standard / NjNQ Termomit në njërin nga gazetën kombëtare dhe lokale që qarkullojnë në Kosovë, brenda (5) ditëve të punës, pas shpalljes dhe publikimit të vendimit nga ana e ZRrE-së në faqen e saj zyrtare në internet.
3. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) do të përdorë të drejtat sipas ligjit, për të verifikuar të dhënat, llogaritë kontabël dhe faturat e NKP Standard / NjNQ Termomit, e gjithashtu do të bëjë bashkërendimin e tarifës aktuale (sezoni ngrohjes 2006/2007) me tarifën e reja të projektuar për sezonin 2007/2008.
4. Gjatë sezonit të ngrohjes 2006/2007 NKP Standard / NjNQ Termomit mund të paraqesë para Zyrës së Rregullatorit për Energji propozimin për ndryshime të arsyeshme të tarifave të aprovuara nga ZRrE-ja në pajtim me Udhëzimin e Përkohshëm I\_03\_2006 “Mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrohjes 2006/2007”.
5. NKP Standard / NjNQ Termomit ka të drejtë ankese ndaj vendimit të ZRrE-së duke dorëzuar raportin e plotë të dëshmuar brenda dhjetë (10) ditësh kalendarik pas shpalljes dhe publikimit të këtij vendimi të ZRrE-së në faqen e saj zyrtare në internet.
6. Duke ju referuar paragrafit 1 të këtij vendimi, Bordi i ZRrE-së do të konsiderojë të shqiptojë dënimin e duhur sipas Nenit 57 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe Nenit 5.4 të Udhëzimit të Përkohshëm I\_03\_2006, për dështim të NKP Standard / NjNQ Termomit të dorëzojë informatat e kërkuara për shqyrtimin e çmimeve të ngrohjes qendrore për sezonin 2006/2007.

**TARIFAT E NGROHJES PËR NDERMARRJEN KOMUNALE PUBLIKE "STANDARD" / NJESIA E NGROHJES QENDRORE "TERMOMIT" PËR SEZONIN E NGROHJES 2006/2007**

**Tabela A. TARIFA PË KONSUMATORËT E PA-NJEHSUAR**

NPK "STANDARD" / NjNQ "TERMOMIT"		
Komponentet e Tarifave	Amvisri	Komercial dhe Institucional
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	PA	€0.25 / m2 për muaj
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	PA	€1.05 / m2 për muaj

PA: e Pa-aplikueshme

**Tabela B. TARIFA PËR KONSUMATORËT E NJEHSUAR**

NPK "STANDARD" / NjNQ "TERMOMIT"	
Tarifa mujore e kapacitetit të ngrohjes ne kW (komponenta fikse)	PA
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta fikse)	PA

PA: e Pa-aplikueshme

Inkurajojmë Ndërmarrjet e Ngrrohjes Qendrore që të matin konsumin e ngrohjes nëpër nënstacione sa më shumë që të jetë e mundur përmes njehsorëve të kalibruar të ngrohjes, posaçërisht për konsumatorët komercialë dhe institucionet.

Bordi i ZRrE-së:

\_\_\_\_\_  
Nick Frydas, Kryesues,

\_\_\_\_\_  
Nysret Avdiu, anëtar

\_\_\_\_\_  
Merita Kostari, anëtare,

\_\_\_\_\_  
Naim Bejtullahu, anëtar

\_\_\_\_\_  
Theranda Beqiri, anëtare